

LEDIA DUSHKU

**DISA TË DHËNA PËR ESAT PASHË TOPTANIN NË FONDET
E ARKIVIT DIPLOMATIK ITALIAN
(1915-1916)***

Arkivi Diplomatik dhe Historik i Ministrisë së Punëve të Jashtme të Italisë ruan një pasuri të jashtëzakonshme dokumentare, që ndriçon e plotëson sa ngjarjet dhe figurat historike kombëtare italiane, aq edhe ato ballkanike e më gjerë, pa përjashtuar këtu edhe ato shqiptare. E ndodhur gjeografikisht afër Shqipërisë, Italia, një nga gjashtë fuqitë e Koncertit Evropian, në vitet e Luftës së Parë Botërore nuk i fshihte më interesat e drejtpërdrejta territoriale ndaj fqinjit të saj, të vogël e të varfër. Ky konstatim i jep dokumenteve të arkivit të mësipërm një rëndësi të madhe në shkrimin e historisë së shqiptarëve përgjatë Luftës së Përbotshme.

Prezantimi ynë mbështetet në disa të dhëna për Esat Pashë Toptanin, pjesë e Arkivit Politik, Serisë së Zakonshme dhe të Kabinetit (1915-1918), Shqipëria, Pako 3 dhe Pako 14, Fashikujt 390-391 (Archivio Politico, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Albania, Pacco 3; Pacco 14, F. 390-391).

Në shtator të vitit 1917, gazetari Leonardo Azzarita i nisi një letër drejtorit të gazetës së Milanos “Perseveranca”, me anën e së cilës ai kërkonte t’i kthente përgjigje një shkrimi në një të përditshme zvicerane rreth prirjeve dhe veprimtarisë së Esat Pashë Toptanit. “Do të dëshiroja, shprehej ai, që të merrnit parasysht edhe faktin, se para ndërmarrjes së një hapi të tillë u këshillova me përfaqësuesit më të denjë të inteligjencës dhe rinisë shqiptare. Të frymëzuar nga idealet kombëtare, prej kohësh ata e kanë gjykuar si të turpshme veprën e Pashait, një vepër e cila është e njohur nga të gjithë ata, që merren me çështjet shqiptare dhe njohin dredhitë e metodat nëpërmjet të cilave Esat Toptani është përpjekur dhe vazhdon të përpiqet të shndërrohet në përfaqësuesin e Shqipërisë.... Askush nuk e injoron faktin, se ai pati mbështetjen dhe ndihmën e Italisë gjatë kohës kur qeveria italiane e kishte konsideruar të dobishme të

* Kumtesë e mbajtur në edicionin e tretë të Ditëve të Albanologjisë, organizuar nga Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, 21 nëntor 2011.

mbështeste një larvë të qeverisë [së Wied-it] me qëllim që të mbante ende në jetë një Shqipëri që po jepte shpirt....Loja e vjetër e dhëlpërisë orientale e shfaq kurthin e saj në momentin kur ai [Esad Toptani] pranon se ka intriguar me serbët dhe grekët, të cilët edhe nëse nuk kanë qenë armiq të Italisë, nuk ka fije dyshimi që janë armiq të Shqipërisë”.

Me shprehje të forta e të shprehura qartë, gazetari italian vazhdon: “Esad Toptani është dhe do të jetë gjithmonë, një përfaqësues i feudalizmit alla turk për të cilin fjalët Atdhe, lartësim moral dhe politik, progres dhe demokraci janë fjalë të pakuptueshme. Për Esad Pashën shteti shqiptar duhet të jetë një lloj pashallëku apo sulltanati të cilin ai duhet ta përdorë sipas dëshirave të tij;duhet të jetë patjetër ajo duzinë çifligjesh, të cilat në të shkuarën përbënin feudin e paraardhësit të tij më të njohur, famëkeqit Kapllan Toptani....Në veri, në qendër dhe në jug [të Shqipërisë] ai urrehet njëlloj për shkak të së shkuarës së tij tiranike. Emri i tij është sinonim prepotence, kaosi dhe taksash. Edhe në vetë qytetet e Toptanëve, në Tiranë dhe Krujë, ai ka kundra katër të pestat e popullsisë, të gjithë fisin dhe të gjithë familjen Toptani. Pra, në emër të kujt flet Esad Pasha, i cili nuk ka qeverisur kurrë aq territore sa të mund të kapte syri i dikujt që ka hipur në majë të plepit?...”¹.

Po kush ishte Esat Pashë Toptani?

Esat Pasha ishte anëtar i familjes Toptani, një familje fisnike ndër më të pasurat e me influencë në Shqipëri dhe më e madhja në Shqipërinë e Mesme. Që në rini ishte dalluar për karakterin e tij të guximshëm, dinak, ambicioz, egoist, egocentrik dhe natyrën e tij tejet praktike. Ishte zotërues i një kulture orientale, jo shumë i kultivuar, kokëfortë, që mendohej se i nënshtrohej veç forcës. Karriera e tij ushtarake pësoi ngritje në vitin 1897, në luftën e Kretës, kur drejtoi garnizonin osman të Janinës. Më 1908, kohë kur shpërtheu Revolucioni i Turqve të Rinj, u deklarua në favor të tij dhe u zgjodh deputet i Durrësit në Parlamentin Osman, post të cilin e fitoi edhe në zgjedhjet e vitit 1912. Si deputet, tregoi se s’kishte humbur asgjë nga karakteri i tij aventurier dhe i dhunshëm, që dinte të luante kartën e pazarllëqeve me atë që i premtonte dhe e paguante më shumë. Me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, u emërua nënkomandant i garnizonit osman në Shkodër dhe komandant i

¹ *Archivio Storico e Diplomatico del Ministero degli Affari Esteri* (më tej: ASDMAE), Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Albania, Pacco 3, Letër e gazetarit Leonardo Azzarita për drejtorin e gazetës *Perserveranca*, shtator 1917.

rezervistëve shqiptarë aty. Në janar 1913, pas eliminimit të komandantit të garnizonit, Riza Hasan Pashës, Esat Toptani mori në dorë drejtimin e tij dhe vendosi të shfrytëzonte situatën për të qenë sa faktor aq edhe aktor në zhvillimet që ofronte realiteti i ri shqiptar, mision të cilin e përmbushi me sukses². Në fund të qershorit pranoi postin e ministrit të Brendshëm në qeverinë e përkohshme të Vlorës, ndërkohë që pak muaj më pas, në tetor 1913 krijoi Pleqësinë e Shqipërisë së Mesme, një autoritet qeverisës që rivalizonte hapur qeverinë e Ismail Qemalit. Në prag të mbërritjes së Princit Wilhelm Wied në Shqipëri, Esat Toptani pranoi të jepte dorëheqjen, por pavarësisht këtij akti ai mbeti sërish faktor dhe aktor i rëndësishëm në zhvillimet e ardhshme në Shqipëri. Krahas drejtimit të delegacionit shqiptar që do t'i dorëzonte kurorën Princ Wied-it, ai siguroi dy poste në qeverinë e re që pritej të krijohej, atë të ministrit të Luftës dhe të Brendshëm, duke qenë kështu anëtari më i rëndësishëm i saj.

Çfarë të dhënash sjellin dokumentet e Arkivit Diplomantik dhe Historik të Romës për veprimtarinë e Esat Pashë Toptanit në vitet e Luftës së Parë Botërore?

Në tërësinë e tyre fondet e këtij arkivi hedhin dritë e plotësojnë tre aspekte të veprimtarisë së pinjollit të Toptanëve përgjatë periudhës 1915-1916.

Së pari në lidhje me marrëdhëniet e tij me Fuqitë e Mëdha dhe këtu kemi parasysh dy prej tyre: Italinë dhe Francën.

Së dyti, hedhin dritë mbi marrëdhëniet e tij me fqinjët ballkanikë: Serbinë dhe Greqinë.

Së treti, qartësojnë përpjekjet e Esat Pashë Toptanit për të legjitimuar, brenda faktorit politik shqiptar, autoritetin e tij qeverisës, krijuar në Durrës në tetor 1914.

Në lidhje me marrëdhëniet e Esat Toptanit me Italinë, Arkivi Diplomantik dhe Historik Italian ka të dhëna të shumta dhe të larmishme. Prej tyre kupton intensitetin e lartë të këtyre marrëdhënieve veçanërisht para se Pashai të zhvendosej nga Durrësi për në Selanik. Gjatë periudhës, tetor 1914- shkurt 1916, ai është subvencionuar periodikisht nga legata italiane në Durrës. Dy herë në muaj, në datat 15 ose 16 dhe 30 ose 31 ai firmoste nga një deklaratë ku bënte me dije marrjen e subvencionit të akorduar. Konstatojmë dy fletë regjistri, njëri për periudhën tetor 1914-15

² Ledia Dushku, *Kur historia ndau dy popuj fqinj. Shqipëria dhe Greqia 1912-1914*, Tiranë: Kristalina-KH, 2012, f. 166-167.

gusht 1915 dhe tjetri për periudhën 15 gusht 1915-16 shkurt 1916. Në periudhën e parë, E. Toptani ka tërhequr nga legata italiane 1.122.135 lireta (1 milion e 122 mijë e 123 lireta), ndërsa në të dytën, më pak, 538.965.36 lireta (538 mijë e 965.36 lireta). Në total për periudhën tetor 1914-shkurt 1916, legata italiane në Durrës është financuar nga shteti italian me një fond prej 1 979. 980.36 liritash (1 milion e 979 mijë e 980.36 lireta). Shuma e tërhequr nga Pashai, është paraqitur në një tabelë të tretë. Ajo përbën afërsisht 84% e fondit të përgjithshëm të legatës, përkatësisht 1.661.100.36 lireta (1 milion e 661 mijë e 100.36 lireta), nga të cilat 1.287.840, afërsisht 78% e shumës janë marrë në monedhë ari, pjesa tjetër rreth 22 % është marrë në kartëmonedhë. Ka një mospërputhje shifrash midis tabelës përfundimtare dhe dy tabelave të ndara sipas periudhave. Kjo mospërputhje, prej 70. 800 liritash, të bën të mendosh se këtë shumë E. Toptani e ka tërhequr nën dorë, pa firmosur deklaratën përkatëse.

Subvencione të mëdha janë bërë gjatë muajve prill-maj 1915, kohë kur Italia sapo kishte nënshkruar Traktatin e Fshehtë të Londrës, duke i dhënë përfundimisht fund asnjësisë në konfliktin botëror dhe, duke konfirmuar qartë synimet e saj ndaj Shqipërisë. Edhe në dhjetor të 1915-ës, Esat Toptani ka marrë subvencione të mëdha nga legata italiane në Durrës. Arsyen duhet ta kërkojmë tek shfuqizimi i taksës doganore të importit, veprim për të cilin shpërblimi nuk mund të mungonte. Më 28 dhjetor 1915, legata italiane në qytetin bregdetar njoftoi qendrën se “Duke filluar nga dita e sotme Esadi ka shfuqizuar taksën doganore prej 10 % për importet nga Durrësi në brendësi të Shqipërisë. Kjo masë e ndërmarrë për tregtinë lokale nënkupton për Esadin një humbje prej 50.000 frangash në muaj. Kjo konfirmon edhe më tej atë çka paraqita në telegramin tim me numër 591, rreth mundësisë për të vazhduar me derdhjen e subvencionit mujor për Esadin, edhe pa faturë”³.

Nga telegramet e shumta kupton se Esat Toptani ishte në shërbim të Italisë duke mbështetur sa konsolidimin politik të pozitës së saj në Shqipëri aq edhe atë ekonomik. Me fondet italiane mbahej në këmbë trupa ushtarake, ndryshe xhandarmëria që komandohej prej tij. Të hollat që mbërrinin nga thesari i Bankës Italiane shërbenin si për pagat ashtu

³ ASDMAE, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Albania, Pacco 14, F. 390, Telegram i legatës italiane në Durrës për Ministrinë e Jashtme, Durrës, dhjetor 1915.

edhe për uniformat e tyre. Siç u përmend edhe më lart Italia subvenciononte edhe humbjet ekonomike të Pashës.

Për të pasqyruar sa më sipër po citojmë pjesë nga telegrami që përfaqësuesi italian në Durrës, baroni Aliotti, më 12 dhjetor 1915 i nisi Ministrisë së Jashtme të Italisë.

“Esadi më bëri me dije nevojën e pagesës në ar të kuotës së ardhshme të subvencionit, me qëllim përballimin e shpenzimeve në lidhje me rrogat e xhandarmërisë, kjo për faktin se derisa të arrihet konsolidimi ynë në vend, kartëmonedha jonë ka një qarkullim të kufizuar, vetëm në tregtinë lokale. Me siguri që ajo, do të përdoret gjerësisht pas mbërritjes së trupave tona [në zonën që administrohet nga Esadi], ashtu sikurse ndodh në Vlorë e përreth saj... Do të ishte e domosdoshme për xhandarmërinë shqiptare e cila varet nga Durrësi, që pagesat të kryhen përkohësisht në ar. Një gjë e tillë ka një rëndësi të veçantë duke qenë se është e nevojshme që të mbahet besnike një forcë shqiptarësh e shumë të numër, e cila kryen e do të vazhdojë të kryejë një shërbim të paçmuar.

Do t’i isha mirënjohës Zotërisë Suaj nëse do të jepnit udhëzime me urgjencë në lidhje me këtë çështje, qoftë edhe për dërgimin e të paktën 100.000 liretave në ar”⁴.

Në përfundim, mund të themi se në tërësinë e tyre të dhënat e Arkivit Politik dhe Historik të Ministrisë së Punëve të Jashtme të Romës dëshmojnë se Esat Pashë Toptani në periudhën e Luftës së Parë Botërore, vazhdonte të ishte sa faktor aq edhe aktor në zhvillimet e brendshme dhe në ato ndërkombëtare për Shqipërinë. Si një figurë unike në historinë e çështjes kombëtare shqiptare ai ka krijuar tashmë një fenomen historik të njohur me emrin esadizëm. Dy janë shtyllat ku mbështetet ky fenomen: koncepti primitiv për shtetin, koncept gati mesjetar që lidh shtetin me pronën: Atdheu im-prona ime. Së dyti, e lidhur ngushtësisht me të parën, ndjenja e posesivitetit maksimal në ato territore që i konsideron se të përkasin, ndjenjë kjo që i bën pjesët e tjera objekt shkëmbimi. Në rastin e Esat Toptanit, ndjenja e posesivitetit maksimal lidhej me Shqipërinë e Mesme, ku edhe shtriheshin pronat e tij, ndërkohë që territoret e tjera shqiptare, në veri dhe në jug mund të ishin, pa problem, objekt shkëmbimi.

⁴ ASDMAE, Serie Ordinario e di Gabinetto (1915-1918), Albania, Pacco 14, F. 390, Telegram i legatës italiane në Durrës për Ministrinë e Jashtme, Durrës, 12 dhjetor 1915.

